



FTESË PËR ANKAND PUBLIK (Dhënia e hapësirave/lokaeve me qira)

1. Dhënia e hapësirave afariste me qira

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë njofton të gjithë të interesuarit se ofron hapësirat/lokalet për qiradhënie përmes procedurës së ankandit publik, si në vijim:

Nr.	Njësia	Sipërfaqja	Nr. i lokalit	Çmimi fillestar
1.	Sportel		2	200€
2.	Sportel		3	200€
3.	Lokal	8.32 m ²	17	174.72 €
4.	Lokal	8.32 m ²	18	174.72 €
5.	Hapësirë afariste - Zyre	382.94m ²	22	800 €

Shënim: Të gjitha çmimet janë pa TVSH.

Kriteri i dhënies së kontratës është çmimi më i lartë i ofruar. Në rast që ekziston vetëm një ofertë lidhur me njësinë afariste të caktuar, Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes ka të drejtë të beje negociata me palën e interesuar lidhur me çmimin final të njësisë afariste të caktuar.

Preferencat e dëshirueshme për lëshimin e hapësirave me qira gjatë procesit të ankandit:

- Për sportelet nr.2 dhe nr.3 preferohet zyre, apo veprimtari e ngjashme për kompanit e autotransportuese.
- Për lokalet nr.17, nr. 18 si dhe hapësirën afariste – "Zyre" me nr.22, preferohet zyre, apo veprimtari të ngjashme, për kompani autotransportuese, apo ndonjë veprimtari tjetër e lejuar dhe e cila nuk bie ndesh me veprimtarinë e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë ;

Të drejtë pjesëmarrje kanë personat juridik. Si dëshmi ofrojnë certifikatën e regjistrimit të biznesit. Afati i dhënies me qira është një (1) vjeçar me mundësi vazhdimi.

2. Kushtet dhe obligimet tjera

- Nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand janë të përjashtuar të gjithë debitorët që kanë obligime të pa shlyera ndaj ndërmarrjes NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë.
- Të gjitha palët e interesuara mund t'i shikojnë hapësirat/lokalet çdo ditë pune nga ora 08:00 deri me 16:00.
- Afati për dorëzimin e ofertave është deri me 26.05.2021, ora 14:00, hapja e ofertave bëhet në orën 14:30.
- Ofertat dorëzohen në zarfe të mbyllura dhe dorëzohen në zyrën e arkivit të ndërmarrjes.
- Të drejtë pjesëmarrje në hapjen e ofertave kanë të gjithë ofertuesit.
- Palët fituese në afatin prej 5 ditësh pas mbylljes së procedurës së ankandit duhet t'i nënshkruajnë kontratat mbi qiranë, dhe të bëjnë pagesën e faturës së pare.
- Informatat me të hollësishme mund të merren përmes emali-t: : contact@sap-rks.com. apo në numër të telefonit 038 551 333.